

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA E PËRGJITHSHME  
DREJTORIA E KOORDINIMIT INSTITUCIONAL  
SEKTORI I DEKRIMINALIZIMIT

Nr. 860/1 Prot.

Tiranë më, 03.07.2024

Lënda: Dërgohet kërkesa

✓ Drejtuar: KOMISIONIT QËNDROR TË ZGJEDHJEVE

TIRANË

Për dijeni: KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

GRUPIT PARLAMENTAR TË PARTISË DEMOKRATIKE

KRYETARIT GAZMENT BARDHI

TIRANË

Pesëmbëdhjetë (15) deputetë të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Shqipërisë, në zbatim të nenit 7, pika 1 shkronja “a”<sup>1</sup> të ligji nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, me kërkesën e datës 28.06.2024, të përcjellë, nga Shërbimi Administrativ i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, bashkëlidhur me shkresën nr.2547 prot., datë 28.06.2024, ka kërkuar pranë Prokurorisë së Përgjithshme kryerjen e verifikimit të të dhënave të plotësuar, në Formularin e Vetëdeklarimit, nga subjekti Tonin Marinaj, kryetar i Bashkisë së Malësisë së Madhe.

Në këtë kërkesë të regjistruar, në Prokurorinë e Përgjithshme, me nr. 860 prot., më datë 28.06.2024, pretendohet se subjekti Tonin Marinaj si kandidat për kryetar në Bashkinë e

<sup>1</sup> 1. Verifikimi i të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit të parashikuar në nenin 5, të këtij ligji, kryhet sa herë kjo kërkohet nga:

a) 1/10 e deputetëve, ....për një të zgjedhur në organet e bashkisë...;

Malësisë së Madhe, për zgjedhjet vendore 14 Maj 2023, në kundërshtim me ligjin, në formularin e vetëdeklarimit nuk ka deklaruar të dhënat që lidhen me:

- *Hetimin në kuadër të procedimeve penale nr.1615/2010, nr. 14109/2010 dhe nr. 15892/2011.10RGNR mod.21, si dhe gjykimin e tij me kërkesën datë 29 mars 2016, nga Prokuroria dhe Gjykata e Shkallës së Parë në Firence të Italisë, për kryerjen nga data 23.5.2010 – 23.7.2010 të trafikimit të lëndës narkotike të llojit mariuanë.*

Në referencë të nenit 5, pika 4, gërma “a” e ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, formulari i vetëdeklarimit, për të zgjedhurit dhe kandidatët e organeve të qeverisjes vendore, dorëzohet dhe administrohet nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve.

Në referencë të nenit 7, pika 1, gërma “a” e ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, verifikimi i të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit, të parashikuar në nenin 5 të këtij ligji, kryhet sa herë që kërkohet nga 1/10 e deputetëve, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri dhe Prokurori i Përgjithshëm, për një të zgjedhur në organet e bashkisë apo të qarkut.


Në referencë të nenin 8, pikat 1 e 4, të ligji nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe Kreun III, pika 3 shkronja “c”, dhe Kreut V, pika 4, të Vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, kryerja e verifikimit të të dhënave nga Prokuroria e Përgjithshme kërkohet nga organi përgjegjës për administrimin e formularit të vetëdeklarimit që është i ngarkuar për marrjen e kërkesës për verifikim, sipas këtij ligji, në çdo rast nëse kërkohet nga një prej subjekteve që gëzojnë të drejtën e nismës për verifikimin e të dhënave, sipas nenit 7, të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Për më sipër, bashkëlidhur ju dërgojmë për kompetencë kërkesën datë 28.06.2024, të pesëmbëdhjetë deputetëve të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Shqipërisë, për verifikimin e të dhënave të vetëdeklaruara, në formularin e vetëdeklarimit, nga subjekti vetëdeklarues Tonin Marinaj, aktualisht me funksionin kryetar i Bashkisë së Malësisë së Madhe.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin!

**DREJTORI**

**KOSTAQ BELURI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

*Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike*

Tiranë, më 28 / 06 / 2024

## K Ë R K E S Ë

### ***PËR VERIFIKIMIN E TË DHËNAVE TË DEKLARUARA NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË SUBJEKTIT TONIN MARINAJ, KRYETAR I BASHKISË MALËSIA E MADHE***

**Drejtuar:** **PROKURORISË SË PËRGJITHSHME**

*Z. Olsian ÇELA*

*Prokuror i Përgjithshëm*

Z. Prokuror i Përgjithshëm,

Në mbështetje të nenit 7 të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar, ku specifikohet se: “Verifikimi i të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit, kryhet sa herë kjo kërkohet nga 1/10 e deputetëve, për një deputet të Kuvendit të Shqipërisë apo një anëtar të Këshillit të Ministrave, përfshirë Kryeministrin, për një të zgjedhur në organet e bashkisë apo të qarkut, si dhe për anëtarin apo drejtuesin e një organi kushtetues apo të krijuar me ligj dhe që zgjidhet me votim nga Kuvendi i Shqipërisë”, kërkohet nga ana juaj verifikimin e plotë të të dhënave të deklaruara në Formularin e Vetëdeklarimit nga subjekti Tonin Marinaj, kryetar i Bashkisë Malësi e Madhe.

Konkretisht, në zgjedhjet vendore të 14 majit 2023, shtetasi Tonin Marinaj ka kandiduar për kryetar i Bashkisë Malësi e Madhe, nga subjekti politik Partia Socialiste e Shqipërisë. Në formularin e vetëdeklarimit për pyetjen “1. A jeni dënuar me burgim me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?”, është përgjigjur “**Jo**”. Më tej, lidhur me pyetjen “2. A jeni dënuar me burgim me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj, për një cështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë?”, është përgjigjur “**Jo**”. Dhe po ashtu në pyetjen “3. A keni qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj, për kryerjen e një vepre penale?”, është përgjigjur “**Jo**”. Këto deklaratime të shtetasit

Marinaj të bërë në formularin e vetëdeklarimit rezultojnë të jenë të pavërteta, sic do të shpjegojmë në vijim.

Nga informacionet që disponohen nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, ekziston dyshimi i arsyeshëm se subjekti Tonin Marinaj, me detyrë Kryetar i Bashkisë së Malsisë së Madhe, ndodhet në kushtet e ndalimit për të kandiduar dhe për t'u zgjedhur në një funksion të lartë publik, në kuptim të ligjit nr. 138/2015. Për këtë arsye, kërkojmë nga ana juaj që në zbatim të detyrimit të parashikuar nga neni 8, i këtij ligji, të kryeni verifikimet përkatëse.

Kjo kërkesë bëhet në kushtet kur ekzistojnë të dhëna dhe informacione, që ngrenë dyshimin e arsyshëm, se subjekti Tonin Marinaj, ka kryer veprimtari të paligjshme në shtetin italian, si më poshtë vijon:

1. Në datën 5 qershor 2015, **Drejtoria Rajonale Antimafia, e Prokurorisë së Republikës, pranë Gjykatës së Firences**, e përfaqësuar nga prokurori Dr. Giulio Monferini ka njoftuar mbylljen e hetimeve paraprake ndaj personave të hetuar, ku i pari në rradhë rezultoi shtetasi Tonin Marinaj, lindur në Shqipëri, më 05.12.1996, i përfaqësuar nga avokati Michele Parigino. Hetime të kryera në kuadër të **procedimeve penale nr. 1615/2010, nr. 14109/2010 dhe nr. 15892/2011**. Në përmbajtje të akuzës thuhet se **shtetasi Tonin Marinaj është në rolin e themeluesit, nxitësit dhe drejtuesit të një organizatë kriminale e përbërë prej më shumë se dhjetë anëtarësh, me tipare ndërshtetërore, me baza vepruese në Shqipëri dhe Itali, e angazhuar sistematikisht, profesionalisht dhe në vazhdimësi në eksportimin në territorin italian të sasive të mëdha të mariuanës për t'u shpërndarë me pakicë nga anëtarët e organizatës kriminale.**
2. Sipas informacioneve përshkruhen në detaje episodet e trafikimit të lëndës narkotike të llojit mariuanë, si dhe bashkëpunëtorët për kryerjen e këtij aktiviteti, përkatësisht: (i) Episodi i parë: Kreu i organizatës kriminale Tonin Marinaj ka organizuar dhe drejtuar importimin në territorin italian dhe shpërndarjen tek anëtarët të 50 kilogramëve mariuanë në Firence, në datën 29.05.2010; (ii) Episodi i dytë: Kreu i organizatës Tonin Marinaj ka organizuar dhe drejtuar importimin në territorin italian dhe shpërndarje tek anëtarët për shitje të jo më pak se 75 kilogramëve mariuanë, në Firence, në datën 14.06.2010; (iii) Episodi i tretë: Kreu i organizatës Tonin Marinaj ka organizuar dhe drejtuar importimin në territorin italian dhe shpërndarjen tek anëtarët e 42 kilogramëve mariuanë, pjesë e një sasie prej 388 kilogramësh mariuanë të magazinuar në Firence, në Firence, në datën



23.07.2010. Gjatë kontrollit të ushtruar nga Policia në këtë magazinë është gjendur edhe një pistoletë e kalibrit 9 mm dhe 100 gramë kokainë.

3. Në datën 29 mars 2016, prokurori Giulio Monferini ka depozituar në Gjykatën e Firences **kërkesën për gjykim në kuadër të procedimit penal nr. 1615.10 RGNR mod.21** në ngarkim të disa shtetasve, ku i pari në rradhë është shtetasi Tonin Marinaj, lindur në Shqipëri, më 5 dhjetor 1966, i përfaqësuar nga avokati Michele Parigino. Në përmbajtje të këtij akti janë parashtruar tre episodet e mësipërme, si dhe janë përshkruar provat mbi të cilat bazohet akuzat, të cilat kryesisht lidhen me përgjime telefonike në numrave dhe pajisjeve që kanë përdorur anëtarët e organizatës kriminale, e dyshuar si e drejtuar nga shtetasi Tonin Marinaj. Në datën 12 maj 2016, Zyra e Gjykatës për Hetime Paraprake, pranë Gjykatës së Firences, me gjyqtar Angelo Antonio Pezzuti pasi ka shqyrtuar kërkesën për gjykim dhe provat në ngarkim të të pandehurve, ku sërish relatohet se Tonin Marinaj është drejtuesi, organizuesi dhe nxitësi i organizatës kriminale të angazhuar në trafikimin e lëndës narkotike të llojit mariuanë, ka vendosur caktimin e seancës gjyqësore paraprake në dhomë këshillimi në datën 13 tetor 2016.

Nga sa më sipër, rezulton se **ekziston dyshimi i arsyeshëm se shtetasi Tonin Marinaj ka qenë nën hetim dhe më pas sipas procedurës duhet të jetë gjykuar për drejtimin, organizimin dhe nxitjen e një organizate kriminale, të përbërë prej më shumë se dhjetë anëtarësh, me bazë në Shqipëri dhe Itali, për trafikimin e lëndës narkotike të llojit mariuanë në sasi të mëdha në territorin e shtetit italian, duke qenë kështu në kushtet e ndalimit për t'u zgjedhur në pozicionin e kryetarit të Bashkisë Malësi e Madhe.**

Në këto kushte, në mbështetje të neneve 8 dhe 9, të ligjit nr. 138/2015,

#### **KËRKOJMË:**

1. Fillimin e menjëhershëm të verifikimit të thelluar të të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit nga shtetasi Tonin Marinaj, me detyrë kryetar i Bashkisë Malësi e Madhe,
2. Referimin e gjetjeve përkatëse, për hetime të mëtejshme pranë Prokurorisë së Posacme Kundër Kriminimit të Organizuar dhe Korrupsionit (SPAK), për nisje të hetimeve për dyshimin e arsyeshëm të kryerjes së veprës penale të fshehejes së të dhënave në formularin e vetëdeklarimit apo veprimtarit të tjera kriminale.















Përsa më lart, kërkohmë ndjekjen e procedurave përkatëse sipas ligjit, pa asnjë vonesë të qëllimshme dhe të paarsyeshme.

**GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE:**

**KRYETARI  
GAZMENT BARDHI**

**DEPUTETËT:**



1.	Dhimitri Çupi	
2.	Tona Zhupa	
3.	Lheri Gjergji	
4.	Ramëzim Dëkaj	
5.	Sorina Koto	
6.	Albano Velshi	
7.	Sham Bregu	
8.	Elda Hoti	
9.	Edmond Spahiu	
10.	Emelje Dëkaj	
11.	Armeny Hasle	
12.	Derd Belykeshani	
13.	Afron Gjekmarkaj	
14.	Blaljeza Nalberti	
15.	Aslan Dajani	